REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**
**DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr.2315 prot. B.Curri, më 23.5.2025

**PROJEKT - VENDIM**
**Nr.______, datë____.____.2025**

**"Për miratimin e tavaneve pergatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 per Bashkinë Tropoje"**

Këshilli Bashkiak Tropoje në mbledhjen e tij të datës ___/___/ 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, neni 41 pika 1të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenin 37 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 " Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV". Bazuar në Udhëzimin Nr.8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028" dhe shtojcat plotesuese.

**V E N D O S I:**

1. Njohjen me mendimet mbi Programin e Buxhetit Afatmesem 2026-2028.

2. Të miratojë tavanet pergatitore të shpenzimeve të PBA 2026-2028. në nivel programi për Bashkinë Tropoje,

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6 e ligjit 139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore".

| **Ligjshmeria** | **Prgj. Finance&Buxheti** | **Drejtori Ekonomik** | **Kryetari** |
|---|---|---|---|
| **Besar Haxhiaj** | **Suela Abdullai** | **Flutura Haxhiaj** | **Rexhe Byberi** |

**NE MUNGESE DHE ME URDHER**
**ZV.KRYETARE**
**ZYRA ISLAMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TROPOJE

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 145 - Bashkia Tropojë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| **01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 141,052 | 140,306 | 140,449 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 37,658 | 37,658 | 40,752 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 178,710 | 177,964 | 181,201 |
| **06260 - Sherbimet Publike Vendore** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 67,940 | 67,610 | 67,752 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 8,059 | 8,059 | 10,752 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 47,009 | 59,134 | 60,690 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 123,008 | 134,803 | 139,195 |
| **03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 20,118 | 20,118 | 20,118 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 3,386 | 3,386 | 3,386 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 23,504 | 23,504 | 23,504 |
| **04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 9,643 | 9,643 | 9,643 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 3,000 | 3,000 | 3,000 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 12,643 | 12,643 | 12,643 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Sekretari i GMS: **ZYRA ISLAMAJ** Koordinator i GMS: Kryetari i GMS:

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 145 - Bashkia Tropojë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| **04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 25,820 | 25,820 | 25,820 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 25,820 | 25,820 | 25,820 |
| **04520 - Rrjeti Rrugor Rural** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 11,447 | 11,447 | 11,447 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 1,230 | 1,230 | 1,230 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 39,536 | 39,536 | 39,536 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 52,213 | 52,213 | 52,213 |
| **09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 78,040 | 78,040 | 78,040 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 3,664 | 3,664 | 3,664 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 81,704 | 81,704 | 81,704 |
| **09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 4,526 | 4,526 | 4,526 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 1,554 | 1,554 | 1,554 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 6,079 | 6,079 | 6,079 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Sekretari i GMS: **ZYRA ISLAMAJ** Koordinator i GMS: Kryetari i GMS:

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 145 - Bashkia Tropojë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| **08130 - Sport dhe argëtim** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 2,353 | 2,022 | 2,165 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 300 | 300 | 1,000 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 2,653 | 2,322 | 3,165 |
| **10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 4,203 | 4,217 | 4,360 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 1,300 | 1,300 | 2,000 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 5,503 | 5,517 | 6,360 |
| **08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 4,875 | 4,544 | 4,687 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 300 | 300 | 1,000 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 5,175 | 4,844 | 5,687 |
| **10661 - Strehimi social** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 6,774 | 6,774 | 6,774 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 6,774 | 6,774 | 6,774 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Sekretari i GMS: **ZYRA ISLAMAJ** Koordinator i GMS: Kryetari i GMS:

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 145 - Bashkia Tropojë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| **04940 - Fondi Kontigjence** | | | |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 13,815 | 14,243 | 14,661 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 13,815 | 14,243 | 14,661 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Totali i Shpenzime Personeli (600-601) | 370,017 | 368,293 | 369,007 |
| Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 71,266 | 71,694 | 80,000 |
| Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 96,319 | 108,445 | 110,000 |
| **Tavanet e Përgjithshme** | 537,602 | 548,431 | 559,007 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Sekretari i GMS: **ZYRA ISLAMAJ** Koordinator i GMS: Kryetari i GMS:

R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë
**BASHKIA TROPOJE**
**DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr.2415/1 prot. B.Curri, më 23.5.2025

# RELACION

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Tropojë Nr.101 datë 24.12.2024 "Për miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe të buxhetit vjetor 2026", Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Tropojë, është mbështetur në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, ka përgatitur dhe po paraqet për miratim para Anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Tropojë, tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, në nivel programi buxhetor.

Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2026-2028, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, Bashkia Tropojë ka analizuar burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.

Këto vlerësime si për të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore edhe për Bashkinë Tropojë përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Bashkia Tropojë në hartimin e projektbuxhetit afatmesëm për periudhën 2026-2028 dhe konkretisht në proçedurat për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 është mbështetur në kuadrin ligjor të miratuar para dhe gjatë vitit 2025.

Kështu bazuar në Udhëzimin Nr.8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", shtojca 3 Kurset e këmbimit për vitet 2021-2025, dhe parashikimi për vitet 2026-2028, bazuar në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, jepen si më poshtë:

| Nr | Monedhat | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD | 103.5 | 113 | 100.6 | 93.1 | 93.1 | 93.1 | 93.1 | 93.1 |
| 2 | Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO | 122.5 | 119 | 108.8 | 100.7 | 100.7 | 100.7 | 100.7 | 100.7 |

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Tropojë së bashku me transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale (transfertën specifike) si dhe transferta e kushtëzuar (Fondet e Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë, Gjendjes Civlile dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit), kanë financuar funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen, niveli i tranfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj dhe kjo do të na bëhet e ditur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Transferta e pakushtëzuar për periudhën 2026-2028, bazuar në Udhëzimin Nr.8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën 2026-2028, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Shtojca 1 "Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë Tropojë për periudhën 2026-2028

*në mijë lekë*

| Bashkia | 2025 (VKB Nr100 Datë 24.12.2024) | 2026 (Plan) | 2027 (Plan) | 2028 (Plan) |
|---|---|---|---|---|
| Bashkia Tropojë | 286,463 | 296,631 | 306,961 | 317,037 |

Sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", theksohet se Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2026-2028 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Në përllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026, kriteret e përdorurara dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2026-2028 janë:

- popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit),
- dendësia e popullsisë për $km^2$,
- numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Madhësia e koeficientëve dhe të dhënat e nevojshme për llogaritjen e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2026-2028 do të jenë në përputhje me përcaktimet e Ankesit 1, të ligjit vjetor të buxhetit 2025.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale (transfertës specifike) sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2026-2028 do të jetë referuar treguesve kryesor të kuadrit makroekonomik e fiskal 2026-2028.

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale po sipas udhëzimit të mësipërm, për periudhën 2026-2028, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

*në milionë lekë*

| **Vitet** | **2026** | **2027** | **2028** |
|---|---|---|---|
| Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale | 140,106 | 140,106 | 140,106 |

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2026-2028 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2025.

Transfertë të veçantë për emergjencat civile (në rang kombëtar) për periudhën 2026-2028, sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028" nuk do të ketë, kjo pasi ka ndryshuar edhe mënyra e trajtimit të emergjencave në njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", me qëllim mbrojtjen e banorëve të Bashkisë nga fatkeqësitë natyrore dhe mbrojtjen civile.

Bashkia Tropojë në zbatim të Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", do të planifikojë nga të ardhurat e veta të Bashkisë për vitin 2025 fondin për Emergjencat Civile fond i cili do t'i bashkohet alokimeve të fondeve qëndrore për Emergjencat Civile.

Ndërsa përsa i takon të ardhurave të veta, Formati F1, "Parashikimi i burimeve të të ardhurave të Bashkisë Tropojë " në

***në mijë lekë***

| **Bashkia** | **2025** (VKB Nr.100 Datë 24.12.2024) | **2026 (Plan)** | **2027 (Plan)** | **2028 (Plan)** |
|---|---|---|---|---|
| Bashkia Tropojë | 64,500 | 65,000 | 65,500 | 66,000 |

Të ardhurat e Bashkisë Tropojë janë përllogaritur për çdo burim të ardhurash veç e veç, bazuar në të dhënat historike që ka Sektori I tatim taksave të Bashkisë Tropojë. Duke ndjekur metodologjinë e IPF (Instrumenti i Planifikimit Financiar), përllogaritja e të ardhurave të veta merr parasysh ndikimin e rritjes ekonomike, të rritjes së popullsisë, ndryshimet rregullatore, ndryshimet e nivelit të taksave dhe shfrytëzimin e përmirësuar të potencialit të taksave.

**Pergjegjese e Financës dhe Buxhetit**
**Suela Abdullai**

**Zv/Kryetare**
**Zyra Islamaj**